PROÇESVERBAL

Nga seanca e këshillit e mbajtur me 30.11.2022 me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës.

Seancën e hapi Kryetari I këshillit Bujar Baftjari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr.arkivor 08-/1579/1 në përbërje prej 6 pikave.

REND DITE

1. Miratimi I procesverbalit të10-të dhe Procesverbalit te 11-të
2. Propozim- Vendim për synimin e realizimit të projektiti në huamarrje përmes projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik (PEESP) dhe autorizim për nënshkrim të kontratës fillestare.
3. Propozim-Vendim për miratimin e laboratit për përcaktimin e zonave mbrojtëse për rreth objekteve për marrjen e ujit-puseve të eksplantimit në lokacionin " Dy Fazana".
4. Propozim-Vendim për dhënie pëlqim planit vjetor për punësim të Komunës së Zhelinës për vitin 2023.
5. Nismë për përgatitjen e Planit Lokal të Veprimit për Mjedisin Jetësor (PLVMJ) të komunës së Zhelinës-Vendim pëe ngritjen e një strukture organizative për projektin Përpilim I PLVMJ për komunën e Zhelinës.
6. Kërkes për korrigjimin dhe plotësimin e çmimores per lartësin e çmimeve dhe depozitimit të mbetjeve.
7. Vendim për ndryshim dhe plotësim të mjeteve në Buxhetin e Komunës së Zhelinës për vitin 2022.

Pas prezantimit të pikave të rendit të ditës, kryetari I këshillit Bujar Baftjari, pyeti nëse dikush nga këshilltarët do ta marr fjalën. Fjalën e kërkoi Bashkim Limani.

-Bashkim L: kërkoi që rendit të ditës t'I shtohet edhe një pikë.

-Vendim për ndryshim dhe plotësim të mjeteve në Buxhetin e komunës së Zhelinës për vitin 2022.

Propozimin e këshilltarit Bashkim L, kryetari I këshillit e hudhin në votim. Me 15 vota pro, dhe 1 kundër ky propozim u miratua.

Kryetari I këshillit Bujar B rendit e ditës të përbërë nga 7 pika e hodhi në votim. Unanimisht u votua rendi I ditës.

Pika 1 – Miratimi I Procesverbalit të10-të dhe Procesverbalit të 11-të.

-Kryetari I këshillit prezantoi pikën në fjalë dhe pyjeti nëqoftëse ndonjëri nga këshilltarët ka të shtoj diçka. Fjala ju dha Rian A.

-Rian A: Tek procesverbali i 9-të, te pika 7, që ka qenë kërkesa për NPK-në, kemi bërë atje pyetje dhe kemi kërkuar shumëçështje,porështë shënuar vetëm një, personalisht tek unë ku kam bisedu për rrugën e fshatit Merovë, shumë shkurtë është shënuar.

Edhe më parë kemi pas ankesa, kërkoj që tëplotësohet proçesverbali.

-Kryetari I këshillit pikën numër 1 e hodhi në votim, ku unanimisht miratohet kjo pikë.

Pika 2- Propozim – Vendim për synimin e realizimit të projektit në huamarrje përmes projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik (PEESP) dhe autorizim për nënshkrim të kontratës fillestare.

Kryetari I këshillit prezantoi pikën në fjalë dhe pyeti nëqoftëse ndonjëri nga këshilltarët ka të shtoj diçka. Fjala ju dha Naser M.

-Naser M: Kërkoi që përgjegjësi të elaboroi pak në këtë pikë. Edhe pse kam ca informacione.

-Adil E: Sqaroi se bëhet fjalë për një thirrje të cilën e ka hap Njësia për Inplementimin e projekteve pranë Ministrisë së Financave, gjegjësisht Bankës Botërore. Thirrja ka të bëjë me realizimin e projektit kryesisht me theks në efikasitetin energjetik. Dhe shpjegoi detajisht rreth këtij projekti.

Kryetari I këshillit pikën nr.2 e hodhi në votim, ku unanimisht u miratua.

Pika 3- Propozim-Vendim për miratimin e laboratit për përcaktimine zonave mbrojtëse për rreth objekteve për marrjen e ujit-puseve të eksplantimit në lokacionin " Dy Fazana".

Kryetari I këshillit pasi prezantoi pikën e 3, hapi diskutim. Fjala ju dha këshilltarit Naser M.

-Naser M: Kërkoi nga përgjegjësit me pika të shkurtra një sqarim për këtë laborat.

-Adil E: Në vija të trasha është një elaborat që e kemi porosit dhe që e ka përgatitur Instituti I Ndërtimit në Shkup. Ky elaborat është bërë që të përcaktohen zonat për rreth puseve ku bëjmë ne eksplatimin e ujit, ku marrim ujë për furnizimin me ujë të pijshëm për Zhelinën dhe fshatrat e tjerë, pra në këtë elaborat definohen zonat ku kufizohen aktivitete ndërtimore, pra në zona ku nuk kemi të drejtë të bëhen ndërtime, që të mbrohen puset, mos ndotet uji I pijshëm.

Kryetari I këshillit pikën nr. 3 e hudhi në votim, e cila unanimisht u miratua.

Pika 4 – Propozim – Vendim për dhënie pëlqim planit vjetor për punësim të Komunës së Zhelinës për vitin 2023.

-Kryetari I këshillit pas prezantimit të pikës, hapi diskutim. Fjala ju dha Naser M.

- Naser M: Në dokument shoh propozime vetëm për udhëheqësit e sektorëve, ajo që më habit është ca udhëheqës për turizëm. Çfarë turizmi ka te ne? Edhe parashihen pagesa shumë të larta. Te pikat tjera nuk ndalem, por shoh vetëm avansime të këtyre që punojnë aktualisht. Nuk e shoh të arsyeshme që kjo pikë të kaloj në këtë moment.

-Rian A:Deshta të shtoj se a janë paraparë mjetet për avanismet apo do ketë ngërç. A janë paraparë këto mjete apo do ketë kolaps?

Sqarime për këtë pikë dha përpiluesi I kësaj programe Ibrahim Xhelili.

- Ibrahim Xh: Ne si komunën bëjmë propozimin e Planit vjetor për vitin 2023. Çdo institucion e ka obligim ligjor që të përpilojë program.
- Naser M: Këto janë punësime të reja apo avansime?
- Ibrahim Xh: Edhe punësime të reja edhe avansime.
- Rian A: Domethënë, nuk do të realizohet ky plan. Vitin e kaluar erdh çmimi i tarifave se sa paguhen të punësuarit me kontratë, pra me këtë metodë do ketë punësime me kontratë?

- Elmedina Z: Më fal që të ndërhyjë koleg, por kjo që thua ti është diçka tjetër nga kjo që po diskutojmë. Ne po flasim për sistematizimin dhe planin për punësim, kjo duhet të shkoj në Ministrinë e Informatikës dhe komuna ka plan për këtë. Por ka raste që ky plan të refuzohet në Ministrinë përkatëse.

Kryetari I këshillit pikën e 4 e hudhi në votim, ku me 10 vota pro dhe 6 të përmbajtur, konstatoi se kjo pikë kalon.

Pika 5 – Nismë për përgatitjen e Planit Lokal të veprimit për Mjedisin Jetësor (PLMVJ) të komunës së Zhelinës- Vendim për ngritjen e një strukture organizative për projektin, Përpilimi I PLVMJ për komunën e Zhelinës.

Pas prezantimit organizativ kryetari I këshillit hapi diskutim. Fjalën e mori Naser M.

- Naser M: Doja sqarime nga përgjegjësi në pika të shkurta. Dhe këtu shoh ca emra të propozuar, dua ta di pse janë pikërisht këto emra dhe a ka mundësi të ndryshohen.
- Sedat R: Ky është një plan I propozuar nga Ministria e Ekologjisë në bashkëpunim me Programin për Mjedisin Jetësor I Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Plan për tre vitet e ardhshme për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për formimin e strukturës organizative për përgatitjen e Planit për Përfshirjen me Publikun. Dha sqarime edhe për emrat e vendosur dhe theksoj se mund të ndryshohen.

Këtë pikë kryetari I këshillit e hudhi në votim, ku me 14 vota pro dhe 2 të përmbajtur kjo pikë u miratua.

Pika 6- Kërkesë për korrigjimin dhe plotësimin e çmimores për lartësinë e çmimeve dhe depozitimit të mbetjeve

Kryetari I këshillit pas prezantimit të pikës hapi diskutim. Fjala ju dha këshilltarit Naser M.

- Naser M: Nuk jam kundër kompanisë, por ne nuk I kemi parë kontratat nga kompania dhe komuna. Kjo kompani kërkon rritjen e çmimit që është absurde, çmimi mund të rritet vetëm nëse do na bind që me të vërtetë ia vlen rritja. Dhe kërkoj që kompania të sjellë dokument se sa ka paguar në Rusino për vitin 2022 dhe sa do të paguajë për vitin 2023.
  Ka përmendur se komuna I ka thënë se ka diku 3500 – 4000 kontinier, ky thotë ka 1700 dhe për këtë kërkoj dokument që ta vërtetojmë. Mendoj që kjo kompani nuk ka shpenzime të mëdha për të bërë korrigjimin e çmimit.
- Kryetari Bujar B tha: Duhet të shtoj diçka, përveç ndryshimeve që I kërkon kjo kompani, kërkon që të përcaktohen edhe dy kategori të tjera që nuk I ka pas në çmimore. A jeni që të bëjmë, ta caktojmë çmimin për kategoritë e tjera që I ka, apo të jetë konform çmimi si është në bazë 120 litra.
- Naser M: Unë them 260 den është për 120 litra, unë nuk ndërhyjë se çfarë çmimi do të vendos për 240 litra, ta propozoj kompania një çmim dhe ne do ta shohim pastaj. Pra kjo kompani bazohet që 120 litra të bëjë 350 den, pastaj këto të tjerat ka shku në bazë të 120 litra. Kompanisë I them kështu 120 litra ta ketë 260 den, pastaj tjerat konform asaj të bëhet çmim tjetër, dhe jo këtë në kërkes.
- Bujar B: Atëhere propozimi ngelet që të jetë 260 den për 120 litra. Pra kush është për propozimin e këshilltarit Naser M.

Propozimi u votua unanimisht.

Pika 7- Vendim për ndryshim dhe plotësim të mjeteve në Buxhetin e komunës së Zhelinës për vitin 2022.

Pas prezantimit të pikës së fundit, kryetari I këshillit hapi diskutim. Fjala ju dha këshilltares Zeqije Bajrami, e cila kërkoi sqarime për pikën në fjalë.

- Adil E: Dha sqarime të detajuar për këtë pikë

Kryetari I këshillit pikën e hudhi në votim. U votua unanimisht nga të gjithë këshilltarët.

Pas kësaj kjo seancë u konsiderua e mbyllur.

Këshilli I Komunës Zhelinë.

Kryetar

Bujar Baftjari

Nr. 08-/1579/2

30.11.2022-të

Zhelinë

Procesverbalist

Albineta Alija